# Instruksionet e përdorimit

Quality, Design and Innovation

home.liebherr.com/fridge-manuals

LIEBHERR

# Përmbajtja


**1 Pajisja në një vështrim të shpejtë..... 3**
1.1 Përmbajtja e dërgesës..... 3
1.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve..... 3
1.3 SmartDevice..... 3
1.4 Fusha e përdorimit e pajisjes..... 4
1.5 Konformiteti..... 4
1.6 Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH..... 4
1.7 Baza e të dhënave EPREL..... 4

**2 Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë..... 5**

**3 Vënia në punë..... 6**
3.1 Ndezja e pajisjes..... 6
3.2 Vendosja e pjesëve..... 6

**4 Menaxhimi i ushqimeve..... 7**
4.1 Ruajtja e ushqimeve..... 7
4.2 Kohët e ruajtjes..... 7

**5 Kursimi i energjisë..... 7**

**6 Përdorimi..... 8**
6.1 Elementët e komandimit dhe tregues..... 8
6.1.1 Treguesi Status..... 8
6.1.2 Navigimi..... 8
6.1.3 Struktura e komandimit..... 8
6.1.4 Simbolet treguese..... 8
6.2 Logjika e përdorimit..... 9
6.2.1 Aktivizimi /çaktivizimi i funksionit..... 9
6.2.2 Zgjedhja e vlerës së funksionit..... 9
6.2.3 Aktivizimi /çaktivizimi i cilësimit..... 9
6.2.4 Zgjedhja e vlerës së cilësimit..... 9
6.2.5 Hapja e menysë së klientit..... 10
6.3 Funksionet..... 10
Fikja e pajisjes..... 10
WLAN..... 10
Temperatura..... 11
Njësia e temperaturës..... 11
SuperFrost..... 11
PartyMode..... 11
SabbathMode..... 11
E-Saver..... 12
IceMaker*..... 12
Kubat e akullit*..... 13
MaxIce*..... 13
TubeClean*..... 13
Drita e ekranit..... 13
Alarmi i derës..... 13
Bllokimi i panelit..... 13
Informacion..... 14
Kujtesa..... 14
Rivendosja në gjendje fillestare..... 14
6.4 Mesazhet e gabimeve..... 14
6.4.1 Paralajmërimet..... 14
6.4.2 Mesazhet..... 14
6.4.3 DemoMode..... 14

**7 Pajisjet..... 15**
7.1 Sirtarët..... 15
7.2 Rafti me tërheqje me IceTower*..... 15
7.3 Pllakat e xhamit..... 17
7.4 EasyTwist-Ice*..... 17
7.5 IceMaker*..... 18
7.6 VarioSpace..... 18
7.7 Aksesorët..... 18

**8 Mirëmbajtja..... 19**
8.1 Çmontimi / montimi i sistemit me tërheqje..... 19
8.2 Shkrirja e pajisjes..... 20
8.3 Pastrimi i pajisjes..... 20

**9 Ndihma për klientin..... 22**
9.1 Të dhënat teknike..... 22
9.2 Zhurmat gjatë punës..... 22
9.3 Defektet teknike..... 23
9.4 Kujdesi për klientin..... 24
9.5 Etiketa e parametrave..... 24

**10 Nxjerrja jashtë pune..... 24**

**11 Hedhja/asgjësimi..... 25**
11.1 Përgatitja e pajisjes për asgjësimin..... 25
11.2 Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike..... 25


Prodhuesi punon në vazhdimësi për zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha llojeve dhe modeleve. Për këtë arsye, lutemi në mirëkuptimin tuaj që ne duhet të rezervojmë të drejtën e ndryshimeve në formë, pajisje dhe teknologji.

| Simboli | Shpjegimi |
|---|---|
| | **Lexoni manualin e instruksioneve**<br>Për t'u njohur me të gjitha avantazhet e pajisjes suaj të re, ku lutemi të lexoni me kujdes udhëzimet në këtë manual instruksionesh. |
| | **Manuali i plotë i instruksioneve në internet**<br>Instruksionet e detajuara i gjeni në internet nëpërmjet kodit QR në kopertinën e këtij manuali ose duke futur numrin e servisit në adresën **home.liebherr.com/fridge-manuals**.<br>Numrin e servisit e gjeni në etiketën e parametrave:<br>  <br>*Fig.* Shembull ilustrues |
| | **Kontrolli i pajisjes**<br>Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ose te kujdesi për klientin. |

| Simboli | Shpjegimi |
|---|---|
| * | **Ndryshimet**<br>Manuali është i vlefshëm për disa modele, kështu që mund të ketë ndryshime. Seksionet që kanë të bëjnë vetëm me pajisje të caktuara janë të shënuara me një yll (*). |
| ▷<br>▶ | **Udhëzimet e veprimeve dhe rezultatet e veprimeve**<br>Udhëzimet e veprimeve janë të shënuara me një ▶.<br>Rezultatet e veprimeve janë të shënuara me një ▷. |
| ▶ | **Videot**<br>Videot për pajisjet ofrohen në kanalin në YouTube të kompanisë Liebherr-Hausgeräte. |

Këto instruksione përdorimi vlejnë për:

| | |
|---|---|
| FN d/e/f | 42/46/50/52... |
| FN c/d | 66/70/72... |
| FN sf e | 5227 |
| SFN (bd/sd/sf) e | 52... |
| GNeu | 1460-e/1460 D |
| LTGN-234<br>LTGN-314 | |
| GN | 4Z2fa4/4Z6fa5/5Z0fa6/5Z2fa7 |
| GNe | 42Z4/46Z5/50Z6/52Z7 |

**Shënim**
Nëse pajisja juaj ka një N në emërtimin e pajisjes, atëherë bëhet fjalë për një pajisje NoFrost.

# 1 Pajisja në një vështrim të shpejtë

## 1.1 Përmbajtja e dërgesës

Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ose te kujdesi për klientin (shihni 9.4 Kujdesi për klientin) .

Dërgesa përbëhet nga pjesët e mëposhtme:
- Pajisje me qëndrim të pavarur
- Pajisjet (në varësi nga modeli)
- Materiali i montimit (në varësi nga modeli)
- „Quick Start Guide“
- „Installation Guide“
- Broshura e shërbimit

## 1.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve



*Fig. 1 Shembull ilustrues*

**Pajisjet**

**(1)** Elementët e komandimit
**(2)** Etiketa e parametrave
**(3)** Sirtari me anim*
**(4)** SpaceBox*
**(5)** IceTower*
**(6)** IceMaker* / EasyTwist-Ice*
**(7)** Tabakaja e ngrirjes*, pllakat ftohëse*
**(8)** Forma e kubave të akullit*
**(9)** Lopata e kubave të akullit*
**(10)** NoFrost
**(11)** Kanali i ajrimit
**(12)** VarioSpace
**(13)** Këmbët me rregullim (përpara), rulet e transportimit (prapa), dorezat e transportit lart (prapa) dhe poshtë (përpara)

**Shënim**
▶ Në gjendjen e dërgimit, raftet, sirtarët ose koshat janë të vendosur për efiçencë energjie optimale. Ndryshimet e sistemimit brenda mundësive të treguara të vendosjes, p.sh. të rafteve në ndarjen e ftohjes, nuk kanë gjithsesi asnjë ndikim në konsumin e energjisë.

## 1.3 SmartDevice

SmartDevice është zgjidhja e lidhjes në rrjet për frigoriferin tuaj ngrirës.

Nëse pajisja juaj mbështet SmartDevice ose është përgatitur për të, ju mund ta lidhni pajisjen shpejt dhe thjeshtë në rrjetin tuaj WLAN. Me aplikacionin SmartDevice mund ta komandoni pajisjen tuaj nga një pajisje fundore celulare. Në aplikacionin SmartDevice keni në dispozicion funksione shtesë dhe mundësi rregullimi.

| | |
|---|---|
| Pajisja e parapërgatitur për SmartDevice: | Pajisja juaj është parapërgatitur për përdorim me SmartDeviceBox. Si fillim duhet të blini dhe të instaloni modulin SmartDeviceBox. Për ta lidhur pajisjen tuaj me rrjetin WLAN, duhet që të shkarkoni aplikacionin SmartDevice. |
| Informacione të tjera për SmartDevice: | **smartdevice.liebherr.com** |
| Blini SmartDeviceBox në dyqanin Liebherr-Hausgeräte në: | **home.liebherr.com/shop/de/deu/smartdevicebox.html** |
| Shkarkoni aplikacionin SmartDevice: | Pas instalimit dhe konfigurimit të aplikacionit SmartDevice mund ta lidhni pajisjen tuaj me ndihmën e aplikacionit SmartDevice dhe të funksionit të pajisjes WLAN (shihni WLAN) në rrjetin tuaj WLAN. |

**Shënim**
Ju nuk mund ta përdorni SmartDeviceBox në shtetet më poshtë: Rusi, Bjellorusi, Kazakistan. Funksioni SmartDevice nuk ofrohet.

## 1.4 Fusha e përdorimit e pajisjes

### Përdorimi i parashikuar

Pajisja është e përshtatshme në veçanti për ftohjen e ushqimeve në sferën familjare ose të ngjashme me sferën familjare. Këtu përfshihet, për shembull, përdorimi

- në kuzhinat e personelit, në mensat e mëngjesit,
- nga vizitorët në bujtina, hotele, motele dhe ambiente të tjera akomodimi,
- në shërbimin katering dhe shërbime të ngjashme në tregtinë me shumicë.

Pajisja nuk është parashikuar për përdorim si pajisje inkaso.

Të gjitha llojet e tjera të përdorimit konsiderohen të palejuara.

### Përdorimi i gabuar i parashikueshëm

Përdorimet e mëposhtme janë shprehimisht të ndaluara:

- Ruajtja dhe ftohja e medikamenteve, plazmës së gjakut, preparateve laboratorike ose substancave dhe produkteve të ngjashme në bazë të Direktivës 2007/47/KE për pajisjet mjekësore
- Përdorimi në ambiente potencialisht shpërthyese

Përdorimi i gabuar i pajisjes mund të çojë në dëmtime të artikujve të vendosur në ruajtje ose mund të çojë në prishjen e tyre.

### Klasat e klimës

Pajisja është projektuar sipas klasave të klimës për përdorimin në temperatura mjedisi të kufizuara. Klasa përkatëse e klimës për pajisjen tuaj është e stampuar në etiketën e parametrave.

**Shënim**

▶ Për të garantuar një përdorim pa probleme të pajisjes, respektoni temperaturat e dhëna të ambientit.

| Klasa e klimës | për temperaturat e ambientit nga |
|---|---|
| SN (Subnormale) | 10 °C deri në 32 °C |
| N (Normale) | 16 °C deri në 32 °C |
| ST (Subtropikale) | 16 °C deri në 38 °C |
| T (Tropikale) | 16 °C deri në 43 °C |
| SN-ST | 10 °C deri në 38 °C |
| SN-T | 10 °C deri në 43 °C |

Nëse pajisja juaj nuk ka një lidhje fikse të ujit, atëherë funksionimi pa probleme i pajisjes është i garantuar deri në një temperaturë të poshtme ambienti prej -15 °C.*

## 1.5 Konformiteti

Qarku i gazit ftohës është testuar për rrjedhje. Pajisja është në përputhje me dispozitat përkatëse të sigurisë dhe me rregulloret përkatëse.

Teksti i plotë i deklaratës EU të konformitetit disponohet në adresën e mëposhtme të internetit: www.Liebherr.com

## 1.6 Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH

Në lidhjen në vijim mund të kontrolloni nëse pajisja juaj përmban substanca SVHC, në kuptim të rregullores REACH: home.liebherr.com/de/deu/de/liebherr-erleben/nachhaltigkeit/umwelt/scip/scip.html

## 1.7 Baza e të dhënave EPREL

Nga data 1 mars 2021, informacionet për etiketimin e konsumit të energjisë dhe për kërkesat e dizajnit

ekologjik do të disponohen në bazën evropiane të të dhënave të produkteve (EPREL). Në lidhjen e mëposhtme https://eprel.ec.europa.eu/ shkoni te baza e të dhënave të produkteve. Këtu kërkohet që ju të futni emërtimin e modelit. Emërtimin e modelit e gjeni në etiketën e parametrave të produktit.

## 2 Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë

Ruani me kujdes këto instruksione përdorimi dhe dorëzojani ato, sipas rastit, edhe pronarit pasardhës.

Nëse do t'i jepni këtë pajisje dikujt tjetër, atëherë dorëzojani instruksionet e përdorimit edhe pronarit pasardhës.

Për ta përdorur pajisjen në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, lexoni me kujdes këto instruksione përdorimi përpara përdorimit të pajisjes. Ndiqni gjithmonë instruksionet që ato përmbajnë, udhëzimet e sigurisë dhe udhëzimet paralajmëruese. Ato janë të rëndësishme, në mënyrë që ta instaloni dhe ta përdorni pajisjen në mënyrë të sigurt dhe të saktë.

**Rreziqet për përdoruesin:**

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore apo me mungesë përvoje dhe njohurish, kur ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe ata i kuptojnë rreziqet që rezultojnë prej tyre. Nuk lejohet që fëmijët të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët pa mbikëqyrje. Fëmijët e moshës 3-8 vjeç lejohen të mbushin dhe të zbrazin pajisjen. Mbani larg pajisjes fëmijët e moshës nën 3 vjeç, nëse ata nuk mbikëqyren në mënyrë të përhershme.
- Priza elektrike duhet të jetë lehtësisht e arritshme, në mënyrë që pajisja të shkëputet shpejt nga energjia elektrike në rast emergjence. Ajo duhet të ndodhet jashtë zonës së pjesës së pasme të pajisjes.
- Kur pajisja shkëputet nga rrjeti elektrik, kapeni gjithmonë nga spina. Mos e tërhiqni nga kablloja.
- Në rast defekti hiqni spinën elektrike nga priza ose fikni siguresën.
- Mos dëmtoni kordonin e lidhjes elektrike. Mos e vini në punë pajisjen me kordon elektrik të dëmtuar.
- Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje lejohen të kryhet vetëm nga kujdesi për klientin ose nga staf tjetër teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- Montoni, lidhni dhe hidhni pajisjen vetëm sipas specifikimeve në manualin e instruksioneve.
- Prodhuesi nuk mban përgjegjësi për dëmet që vijnë për shkak të linjës fikse me probleme të furnizimit me ujë.*

**Rrezik zjarri:**

- Gazi ftohës i pajisjes (specifikimet në etiketën e parametrave) është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës që rrjedh mund të marrë flakë.
  - Mos dëmtoni tubacionet e qarkut të ftohjes.
  - Mos përdorni burime ndezjeje në brendësi të pajisjes.
  - Mos përdorni asnjë pajisje elektrike në brendësi të pajisjes (p.sh. pajisje pastruese me avull, pajisje ngrohëse, makineri akulloreje etj.).
  - Nëse ka rrjedhje të gazit ftohës: Mënjanoni flakën e zbuluar ose burimet e ndezjes në afërsi të vendit të rrjedhjes. Ajrosni mirë dhomën. Njoftoni kujdesin për klientin.
- Mos vendosni në ruajtje brenda në pajisje lëndë eksplozive ose kanaçe spërkatëse me lëndë shtytëse të ndezshme, si p.sh. butan, propan, pentan etj. Kanaçet spërkatëse përkatëse identifikohen tek të dhënat e printuara të përmbajtjes ose nga një simbol flake. Gazet që mund të kenë rrjedhur mund të ndizen nga pjesët elektrike.
- Mbani larg nga pajisja qirinjtë e ndezur, llambat ose objektet e tjera me flakë të zbuluar, në mënyrë që këto të mos i vënë flakën pajisjes.
- Pijet alkoolike ose paketimet e tjera që përmbajnë alkool vendosini në ruajtje të mbyllura në mënyrë hermetike. Alkooli që mund të kenë rrjedhur mund të ndizet nga pjesët elektrike.

**Rreziku i pengimit dhe përmbysjes:**

- Mos i përdorni bazamentin, sirtarët, dyert etj. si shkallë ose si vend për t'u mbështetur. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për fëmijët.

**Rreziku i helmimit nga ushqimi:**

- Mos konsumoni ushqime të ruajtura për kohë shumë të gjatë.

**Rreziku i morthit, i ndjesisë së ngrirjes dhe dhimbjeve:**

- Shmangni kontaktin e zgjatur të lëkurës me sipërfaqet e ftohta ose artikujt e ftohtë/të ngrirë ose merrni masa mbrojtëse, si p.sh. përdorimi i dorezave.

**Rreziku i lëndimit dhe dëmtimit:**

- Avulli i nxehtë mund të shkaktojë lëndime. Për shkrirjen mos përdorni asnjë pajisje ngrohëse elektrike ose pajisje pastrimi me avull, flakë të zbuluara ose spërkatës për shkrirje.
- Mos e hiqni akullin me objekte të mprehta.

**Rreziku i shtypjes:**

- Mos i futni duart te mentesha gjatë hapjes dhe mbylljes së derës. Gishtat mund të kapen aty.

**Simbolet në pajisje:**

Simboli mund të gjendet mbi kompresor. Ai ka të bëjë me vajin në kompresor dhe jep udhëzim për rrezikun e mëposhtëm: Mund të jetë fatal në rast gëlltitjeje ose futjeje në rrugët e frymëmarrjes. Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Në gjendje pune normale nuk ekziston asnjë rrezik.

Simboli ndodhet në kompresor dhe identifikon rrezikun nga lëndët me rrezik ndezjeje. Mos e hiqni etiketën ngjitëse.

Kjo etiketë ngjitëse ose një etiketë e ngjashme mund të ndodhet në pjesën e pasme të pajisjes. Ajo tregon se te dera dhe/ose tek trupi ka panele izoluese me vakuum (VIP) ose panele me perlit. Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Mos e hiqni etiketën ngjitëse.

**Ndiqni udhëzimet paralajmëruese dhe udhëzimet e tjera specifike në kapitujt e tjerë:**

| | | |
|---|---|---|
| ⚠ | RREZIK | Identifikon një situatë të rrezikshme të drejtpërdrejtë, e cila ka si pasojë vdekjen ose lëndime të rënda fizike, nëse nuk mënjanohet. |
| ⚠ | PARALAJMËRIM | Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila mund të ketë si pasojë vdekjen ose lëndimin e rëndë fizik, nëse nuk mënjanohet. |
| ⚠ | VINI RE | Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila mund të ketë si pasojë lëndime fizike të lehta ose mesatare, nëse nuk mënjanohet. |
| | KUJDES | Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila mund të ketë si pasojë dëme materiale, nëse nuk mënjanohet. |
| | Shënim | Identifikon udhëzimet dhe këshillat e dobishme. |

# 3 Vënia në punë

## 3.1 Ndezja e pajisjes

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Pajisja është instaluar dhe lidhur në përputhje me instruksionet e montimit.
- ❑ Të gjithë shiritat ngjitës, fletët ngjitëse dhe mbrojtëse, si dhe sigurueset e transportit brenda dhe jashtë pajisjes janë hequr.
- ❑ Të gjitha fletëpalosjet e reklamave janë hequr nga sirtarët.




*Fig. 2*

▶ Ndizni pajisjen me anë të butonit të përdorimit anash ekranit.
▷ Shfaqet treguesi i statusit.

**Pajisja ndizet në DemoMode:**

Nëse pajisja ndizet në DemoMode, atëherë ju mund ta çaktivizoni funksionin DemoMode brenda 5 minutave.




*Fig. 3*

▶ Mbani shtypur shenjën e konfirmimit anash ekranit për 3 sekonda.
▷ DemoMode çaktivizohet.

**Shënim**
Prodhuesi këshillon:
▶ Futni **ushqimet për ngrirje** në -18 °C ose më shumë.

## 3.2 Vendosja e pjesëve

**Shënim**
Aksesorët mund t'i blini në dyqanin Liebherr-Hausgeräte në adresën e internetit home.liebherr.com/shop/de/deu/zubehor.html.

▶ Vendosni pajisjet e ofruara për ta përdorur pajisjen në mënyrë optimale.

# 4 Menaxhimi i ushqimeve

## 4.1 Ruajtja e ushqimeve

**PARALAJMËRIM**
Rrezik zjarri
▶ Mos përdorni asnjë pajisje elektrike në hapësirën e pajisjes për ushqimet, nëse kjo nuk rekomandohet nga prodhuesi.

**Shënim**
Konsumi i energjisë rritet dhe performanca e ftohjes zvogëlohet kur qarkullimi i ajrit nuk mjafton.
▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit.

Gjatë ruajtjes së ushqimeve mbani parasysh sa më poshtë:
❑ Kanalet e ajrit në faqen e pasme janë të lira.
❑ Kanalet e ajrit në ventilator janë të lira.
❑ Ushqimet janë të paketuara mirë.
❑ Mishi ose peshku i pagatuar është vendosur në enë të pastra dhe të mbyllura, që nuk prekin ushqimet e tjera ose që nuk pikojnë sipër tyre.
❑ Ushqimet janë vendosur në ruajtje në distancë nga njëri-tjetri, me qëllim që ajri të mund të qarkullojë mirë.

**Shënim**
Mosndjekja e këtyre këshillave mund të rezultojë në prishjen e ushqimeve.

### 4.1.1 Dhoma e ngrirjes

Në -18 °C këtu krijohet një klimë ruajtjeje e akullt e thatë. Klima e akullt është e përshtatshme për ruajtjen e ushqimeve të ngrira dhe të produkteve për ngrirje për disa muaj, për përgatitjen e kubave të akullit ose për ngrirjen e ushqimeve të freskëta.

**Ngrirja e ushqimeve**

Ju mund të ngrini maksimumi aq kilogramë ushqime të freskëta brenda 24 orëve sa tregohet në etiketën e parametrave (shihni 9.5 Etiketa e parametrave) në pjesën "Kapaciteti i ngrirjes ... kg/24h".

Me qëllim që ushqimi të ftohet shpejt deri në brendësi, respektoni sasitë e mëposhtme për çdo paketim:
- Fruta, perime, deri në 1 kg
- Mish deri në 2,5 kg

Përpara ngrirjes mbani parasysh:
❑ SuperFrost aktivizohet (shihni 6.3 Funksionet) kur sasia për ngrirje është më e madhe se rreth 2 kg.
❑ Në sasi të vogla të produkteve për ngrirje: SuperFrost është aktivizuar rreth 6 orë më përpara.
❑ Në sasi të mëdha të produkteve për ngrirje: SuperFrost është aktivizuar rreth 24 orë më përpara.

**Ndarja e ushqimeve:**

**VINI RE**
Rrezik lëndimi nga thyerja e qelqit!
Shishet dhe kanaçet me pije mund të plasin nga ngrirja. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për pijet që përmbajnë gaz karbonik.
▶ Ngrijini shishet dhe kanaçet me pije vetëm duke përdorur funksionin *BottleTimer*.

Në sasi të vogla të produkteve për ngrirje:
▶ Vendosni ushqimet e paketuara në sirtarin më të sipërm.
▶ Nëse është e mundur, vendosini ushqimet prapa në sirtar afër faqes së pasme.
Në sasi të mëdha të produkteve për ngrirje:
▶ Shpërndani ushqimet e paketuara në të gjithë sirtarët, megjithatë mos vendosni asnjë ushqim në sirtarin më të poshtëm.
▶ Nëse është e mundur, vendosini ushqimet prapa në sirtar afër faqes së pasme.
Në sasi të mëdha të produkteve për ngrirje:
▶ Pasi SuperFrost të jetë çaktivizuar automatikisht, futni ushqimin brenda në sirtar.

**Shkrirja e ushqimeve**
- në ndarjen e ftohjes
- në mikrovalë
- në furrë/sobë me ajër të nxehtë
- në temperaturë ambienti

**PARALAJMËRIM**
Rrezik i helmimit nga ushqimi!
▶ Mos i ngrini më përsëri ushqimet e shkrira.

▶ Nxirrni nga frigoriferi vetëm aq ushqim sa ju nevojitet.
▶ Përpunoni ushqimet e shkrira sa më shpejt të jetë e mundur.

**Tabakaja e ngrirjes***

Me tabakanë e ngrirjes mund të ngrini fruta pylli, erëza/barishte e perime dhe produkte të tjera të vogla për ngrirje, pa qenë e nevojshme që ato të ngjiten me njëra-tjetrën. Produkti për ngrirje ruan formën e tij në maksimumin e mundshëm dhe ndarja e mëvonshme në porcione është më e lehtë.

Gjithashtu, në tabakanë e ngrirjes mund të mbani pllakat ftohëse, duke kursyer hapësirë.*
▶ Shpërndani ushqimet e papaketuara mbi tabakanë e ngrirjes me distancë nga njëra-tjetra.

## 4.2 Kohët e ruajtjes

Kohët e treguara të ruajtjes janë vlera orientuese.

Për ushqimet me specifikim të afatit të përdorimit vlen gjithmonë data e përcaktuar në paketim.

| Vlerat orientuese për ruajtjen e ushqimeve të ndryshme | | |
|---|---|---|
| Akullore | në -18 °C | 2 deri në 6 muaj |
| Sallame, proshuta | në -18 °C | 2 deri në 3 muaj |
| Bukë, produkte brumi për pjekje | në -18 °C | 2 deri në 6 muaj |
| Mish i egër, mish derri | në -18 °C | 6 deri në 9 muaj |
| Peshk, me yndyrë | në -18 °C | 2 deri në 6 muaj |
| Peshk, pa yndyrë | në -18 °C | 6 deri në 8 muaj |
| Djathë | në -18 °C | 2 deri në 6 muaj |
| Shpendë, mish gjedhi | në -18 °C | 6 deri në 12 muaj |
| Perime, fruta | në -18 °C | 6 deri në 12 muaj |

# 5 Kursimi i energjisë

- Kujdesuni gjithmonë për qarkullimin e mirë të ajrit dhe për ajrimin. Mos i mbuloni vrimat ose grilat e ajrimit.
- Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit.
- Mos e instaloni pajisjen në një vend në rrezet direkte të diellit, pranë sobës, sistemit të ngrohjes dhe të ngjashme.

- Konsumi i energjisë varet nga kushtet e instalimit, për shembull nga temperatura e ambientit (shihni 1.4 Fusha e përdorimit e pajisjes) . Kur temperatura e ambientit është më e ngrohtë, atëherë konsumi i energjisë mund të rritet.
- Hapeni pajisjen mundësisht sa më pak kohë.
- Sa më e ulët të vendoset temperatura, aq më i lartë do të jetë konsumi i energjisë.
- Të gjitha ushqimet vendosini në ruajtje të paketuara mirë dhe të mbuluara. Kështu shmanget formimi akullit/borës.
- Futja e ushqimeve të ngrohta: në fillim lërini të ftohen në temperaturën e dhomës.

# 6 Përdorimi

## 6.1 Elementët e komandimit dhe tregues

Ekrani mundëson një shikim të shpejtë të temperaturës së vendosur, si dhe të gjendjes së funksioneve dhe të cilësimeve. Komandimi i funksioneve dhe cilësimeve bëhet ose nëpërmjet aktivizimit/çaktivizimit, ose nëpërmjet zgjedhjes së një vlere.

### 6.1.1 Treguesi Status

*Fig. 4*
**(1)** Treguesi i temperaturës

Treguesi Status tregon temperaturën e vendosur dhe është treguesi fillestar i rregullimeve. Që aty vijohet me navigimin në funksionet dhe cilësimet e tjera të pajisjes.

### 6.1.2 Navigimi

Aksesin në funksione të veçanta e siguroni nëpërmjet navigimit në meny. Pas konfirmimit të një funksioni ose të një rregullimi tingëllon një tingull sinjalizues. Kur brenda 10 sekondave nuk bëhet asnjë përzgjedhje, ekrani kalon në treguesin Status.

Komandimi i pajisjes bëhet nëpërmjet butonave poshtë ekranit:

*Fig. 5*
**(1)** Shigjeta e navigimit majtas / djathtas
**(2)** Konfirmo

**Shigjeta e navigimit majtas / djathtas** *Fig. 5 (1)***:**

- Navigoni nëpër meny. Pas faqes së fundit të menysë shfaqet përsëri faqja e parë.

**Konfirmo** *Fig. 5 (2)***:**

- Aktivizoni / çaktivizoni një funksion.
- Hapni një nënmeny.
- Konfirmoni një përzgjedhje. Pas konfirmimit ekrani kthehet sërish prapa te menyja.

**Kthimi i ekranit tek treguesi Status:** mënyra më e shpejtë:

- Mbyllni dhe hapni derën.
- Ose pritni për 10 sekonda. Ekrani kalon tek treguesi Status.

### 6.1.3 Struktura e komandimit

Struktura e komandimit shpjegohet me anë të ilustrimit të një modeli. Treguesi ndryshon në varësi të funksionit ose të cilësimeve.

**Menyja ose nënmenyja**




*Fig. 6*
**(1)** Statusi i çaktivizuar / Statusi i aktivizuar vija e bardhë në pjesën lart
**(2)** Simboli ose vlera e aktivizuar
**(3)** Menyja: Emri i funksionit ose menyja: Emri i cilësimit

**Menyja me nënmeny**




*Fig. 7*
**(1)** Menyja: Emri i funksionit ose menyja: Emri i cilësimit
**(2)** Statusi
**(2)** çaktivizuar / aktivizuar
**(3)** Simboli ose vlera e aktivizuar
**(4)** Nënmenyja: Emri i funksionit ose nënmenyja: Emri i cilësimit

Është i mundur navigimi i mëposhtëm:

- Navigoni me shigjetën e navigimit majtas / djathtas *Fig. 5 (1)*.
- Me Konfirmo *Fig. 5 (2)* thërritni nënmenynë *Fig. 7 (4)*.
  - Navigoni me shigjetën e navigimit majtas / djathtas *Fig. 5 (1)*.
  - Vendosja e vlerës së re: Me Konfirmo *Fig. 5 (2)* zgjidhni një vlerë të çaktivizuar *Fig. 6 (1)*.
  - Kthimi te menyja: Me Konfirmo *Fig. 5 (2)* zgjidhni vlerën e aktivizuar *Fig. 6 (2)* më parë.

### 6.1.4 Simbolet treguese

Simbolet treguese janë informacion rreth gjendjes aktuale të pajisjes.

| Simboli | Gjendja e pajisjes |
|---|---|
| | **Standby**<br>Pajisja ose zona e temperaturës është e fikur. |
| | **Numër që pulson**<br>Pajisja është duke punuar. Temperatura pulson, derisa të arrihet vlera e vendosur. |
| | **Simbol që pulson**<br>Pajisja është duke punuar. Rregullimi po pranohet. |
| | **Vija vjen duke u zvogëluar**<br>Funksioni çaktivizohet. |

## 6.2 Logjika e përdorimit

### 6.2.1 Aktivizimi /çaktivizimi i funksionit

Funksionet që mund të aktivizohen /çaktivizohen janë ato më poshtë:

| Simboli | Funksioni |
|---|---|
| | SuperFrost[x] |
| | IceMaker dhe MaxIce[x]* |
| | PartyMode[x] |
| | E-Saver |

[x] Kur funksioni është aktiv, pajisja punon me kapacitet më të lartë. Si rezultat, zhurmat e punës së pajisjes mund të jenë më të larta se zakonisht dhe konsumi i energjisë rritet.

▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa të shfaqet funksioni .
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▷ Dëgjohet tingulli i konfirmimit.
▷ Statusi shfaqet në meny.
▷ Funksioni aktivizohen /çaktivizohet.

### 6.2.2 Zgjedhja e vlerës së funksionit

Në funksionet e mëposhtme mund të caktohet një vlerë në nënmeny:

| Simboli | Funksioni |
|---|---|
| | Vendosja e temperaturës<br>Fikja / ndezja e pajisjes |

▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa funksioni të shfaqet.
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▶ Zgjidhni vlerën e cilësimit me shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)*.

**Vendosja e temperaturës**

▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▷ Dëgjohet tingulli i konfirmimit.
▷ Statusi: aktivizuar *Fig. 6 (1)* shfaqet shkurtimisht në nënmeny *Fig. 7 (4)*.
▷ Ekrani kthehet sërish te menyja.

### 6.2.3 Aktivizimi /çaktivizimi i cilësimit

Cilësimet që mund të aktivizohen /çaktivizohen janë ato më poshtë:

| Simboli | Cilësimi |
|---|---|
| | WiFi[1] |
| | Bllokimi i panelit[2] |
| | SabbathMode[2] |
| | Kujtesat[1] |
| | Rivendosja[2] |
| | Fikja [2] |

▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa të shfaqen cilësimet .
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa të shfaqet cilësimi që dëshironi.

[1] **Aktivizimi i cilësimit (shtypje e shpejtë)**

▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▷ Dëgjohet tingulli i konfirmimit.
▷ Statusi shfaqet në meny.
▷ Cilësimi aktivizohet /çaktivizohet.

[2] **Aktivizimi i cilësimit (shtypje e gjatë)**

▶ Mbani shtypur Konfirmo *Fig. 5 (2)* për 3 sekonda.
▷ Dëgjohet tingulli i konfirmimit.
▷ Statusi shfaqet në meny.
▷ Pamja e ekranit ndryshon.

### 6.2.4 Zgjedhja e vlerës së cilësimit

Në cilësimet e mëposhtme mund të caktohet një vlerë në nënmeny:

| Simboli | Rregullimet |
|---|---|
| | Niveli i dritës |
| | Alarmi i derës |
| | Njësia e temperaturës |

▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa të shfaqen cilësimet .
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa të shfaqet cilësimi që dëshironi.
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▶ Zgjidhni vlerën e cilësimit me shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)*.
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▷ Dëgjohet tingulli i konfirmimit.
▷ Statusi shfaqet shkurtimisht në nënmeny.
▷ Ekrani kthehet sërish te menyja.

### 6.2.5 Hapja e menysë së klientit

Cilësimet e mëposhtme mund të hapen në menynë e klientit:

| Simboli | Funksioni |
|---|---|
| * | TubeClean[2]* |
| * | Kubat e akullit[1]* |
| Software | Software |

▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa të shfaqen cilësimet .
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa në ekran të shfaqet informacioni i pajisjes .
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▶ Futni kodin me shifrat 151.
▷ Shfaqet menyja e klientit.
▶ Në menynë e klientit, shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa të shfaqet cilësimi që dëshironi.

[1] **Zgjedhja e vlerës**
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▷ Dëgjohet tingulli i konfirmimit.
▷ Statusi shfaqet shkurtimisht në ekran.
▷ Ekrani kthehet sërish te menyja.

[2] **Aktivizimi i cilësimit**
▶ Mbani shtypur Konfirmo *Fig. 5 (2)* për 3 sekonda.
▷ Dëgjohet tingulli i konfirmimit.
▷ Statusi shfaqet në ekran.
▷ Simboli pulson, për sa kohë që pajisja është duke punuar.

## 6.3 Funksionet

### Fikja e pajisjes

Ky cilësim mundëson fikjen e të gjithë pajisjes.

**Fikja e të gjithë pajisjes**




*Fig. 8*

▶ Çaktivizimi i IceMaker .*
▶ Aktivizimi / çaktivizimi (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .
▷ Çaktivizuar: Ekrani bëhet i zi.

### WLAN

Me këtë funksion ju lidhni pajisjen tuaj me rrjetin WLAN. Atë mund ta komandoni më pas përmes aplikacionit SmartDevice nga një pajisje fundore celulare. Me këtë funksion ju mund të ndani përsëri ose të rivendosni lidhjen në rrjetin WLAN. Për ta lidhur pajisjen tuaj me rrjetin WLAN, juve ju nevojitet SmartDeviceBox. Informacione të tjera për SmartDeviceBox dhe për përdorimin e aplikacionit SmartDevice: (shihni 1.3 SmartDevice)

**Shënim**
Ju nuk mund ta përdorni SmartDeviceBox në shtetet më poshtë: Rusi, Bjellorusi, Kazakistan. Funksioni SmartDevice nuk ofrohet.

**Realizimi i lidhjes me WLAN**

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ SmartDeviceBox është blerë dhe është vendosur. (shihni 1.3 SmartDevice)
❑ Aplikacioni SmartDevice është instaluar (shihni apps.home.liebherr.com).




*Fig. 9*

▶ Aktivizoni cilësimin. (shihni 6.2 Logjika e përdorimit)
▷ Lidhja po vendoset: Statusi: aktivizuar *Fig. 6 (1)* dhe shfaqet WiFi connecting. Simboli pulson.
▷ Lidhja është vendosur: Statusi: aktivizuar *Fig. 6 (1)*, shfaqet.
▷ Lidhja nuk është vendosur: Shfaqet statusi dhe Connect. Simboli mbetet i dukshëm.

**Shkëputja e lidhjes me WLAN**

▶ Çaktivizoni cilësimin. (shihni 6.2 Logjika e përdorimit)




*Fig. 10*

▷ Lidhja është shkëputur: Simboli mbetet i dukshëm.

**Rivendosja e lidhjes me WLAN**

▶ Rivendosni cilësimet. (shihni 6.2 Logjika e përdorimit)




*Fig. 11*

▷ Lidhja dhe rregullimet e tjera rikthehen në gjendjen e dërgimit të pajisjes.

## Temperatura

Temperatura varet nga faktorët e mëposhtëm:

- shpeshtësia e hapjes së derës
- kohëzgjatja e hapjes së derës
- temperatura e dhomës në vendin e instalimit
- lloji, temperatura dhe sasia e ushqimit

| Dhoma e ngrirjes | Cilësimi i rekomanduar |
|---|---|
| -18 °C | -18 °C |

**Vendosja e temperaturës**




*Fig. 12*

▶ Vendosni vlerën. (shihni 6.2 Logjika e përdorimit)

▷ Temperatura e vendosur tregohet djathtas poshtë në ekran.

## Njësia e temperaturës

Ky cilësim mundëson ndryshimin e njësisë së temperaturës Celsius - Fahrenheit.

**Zgjedhja e cilësimit**

▶ Vendosja e vlerës (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .

## SuperFrost

Me këtë funksion aktivizoni performancën më të lartë të ngrirjes. Si rezultat arrini temperatura ngrirjeje më të thella.

Përdorimi:

- Për të ngrirë çdo ditë më shumë se 2 kg ushqime të freskëta.
- Ushqimet e freskëta ngrijnë shpejt deri në brendësi.
- Rritni rezervat e ftohjes në ushqimet e ruajtura në ngrirje, përpara se të shkrini pajisjen.

**Aktivizimi /çaktivizimi i funksionit**

Në sasi të vogla të produkteve për ngrirje:

▶ Aktivizojeni 6 orë përpara përdorimit.

Në sasi të mëdha të produkteve për ngrirje:

▶ Aktivizojeni 24 orë përpara përdorimit.

▶ Aktivizimi / çaktivizimi (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .

Funksioni do të çaktivizohet automatikisht. Pas kësaj, pajisja vazhdon të punojë me operimin normal. Temperatura rregullohet sërish në vlerën e vendosur.

## PartyMode

Ky funksion ofron një përmbledhje të cilësimeve dhe funksioneve të veçanta, të cilat janë të dobishme gjatë një feste.

Aktivizohen funksionet e mëposhtme:

- *SuperFrost*
- *IceMaker* dhe *MaxIce**

Të gjitha funksionet mund të rregullohen në mënyrë fleksibël dhe individuale. Ndryshimet bëhen të pavlefshme kur funksioni çaktivizohet.

**Aktivizimi /çaktivizimi i funksionit**

▶ Aktivizimi / çaktivizimi (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .

▷ Aktivizuar: Të gjitha funksionet aktivizohen në të njëjtën kohë.

▷ Çaktivizuar: Rivendosen përsëri temperaturat e vendosura më parë.

Funksioni çaktivizohet automatikisht pas 24 orësh.

## SabbathMode

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni SabbathMode. Kur e aktivizoni këtë funksion, disa funksione elektronike do të çaktivizohen. Në këtë mënyrë, pajisja juaj përmbush kërkesat fetare për festat hebraike, si për shembull në Shabat dhe plotëson certifikimin STAR-K Kosher.

| Gjendja e pajisjes me SabbathMode aktiv |
|---|
| Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje SabbathMode. |
| Të gjitha funksionet në ekran përveç **Çaktivizo funksionin SabbathMode** janë të bllokuara. |
| Të gjitha funksionet mbeten aktive. |
| Ekrani qëndron i ndriçuar kur mbyllni derën. |
| Kujtesat nuk ekzekutohen. Intervali kohor i vendosur ndalohet. |
| Kujtesat dhe paralajmërimet nuk shfaqen. |
| Nuk ka asnjë alarm të derës. |
| Nuk ka asnjë alarm të temperaturës. |
| IceMaker është jashtë funksioni.* |
| Cikli i shkrirjes punon vetëm sipas kohës së paracaktuar, pa marrë parasysh përdorimin e pajisjes. |
| Pas një ndërprerjeje të energjisë elektrike, pajisja rikthehet në SabbathMode. |

*Gjendja e pajisjes*

**Shënim**
Kjo pajisje mban certifikimin e institutit "Institute for Science and Halacha". (www.machonhalacha.co.il)

Një listë të pajisjeve të certifikuara nga STAR-K e gjeni në www.star-k.org/appliances.

### Aktivizimi i SabbathMode

**PARALAJMËRIM**
Rrezik helmimi nga ushqimi i prishur!
Nëse keni aktivizuar SabbathMode dhe ndodh një ndërprerje e energjisë elektrike, në treguesin e statusit nuk shfaqet asnjë mesazh për ndërprerjen e energjisë elektrike. Pasi ndërprerja e energjisë elektrike të ketë përfunduar, pajisja vazhdon sërish punën në SabbathMode. Për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike ushqimet mund të prishen dhe konsumimi i tyre mund të shkaktojë helmim nga ushqimi.
Pas një ndërprerjeje të energjisë elektrike:
▶ Mos konsumi ushqimet që kanë qenë të ngrira dhe janë shkrirë.

▶ Hapni menynë Cilësimet. (shihni 6.2 Logjika e përdorimit)
▶ Shtypni shigjetën e navigimit aq herë derisa të shfaqet funksioni përkatës.




*Fig. 13*

▶ Kryeni hapat e veprimit (shihni Fig. 1093) .
▷ SabbathMode aktivizohet.
▷ Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje SabbathMode.

### Çaktivizimi i SabbathMode

▶ Hapni menynë Cilësimet. (shihni 6.2 Logjika e përdorimit)
▶ Shtypni shigjetën e navigimit aq herë derisa të shfaqet funksioni përkatës.




*Fig. 14*

▶ Kryeni hapat e veprimit (shihni Fig. 1094) .
▷ SabbathMode çaktivizohet.

## E-Saver

Ky funksion aktivizon ose çaktivizon modalitetin e kursimit të energjisë. Nëse aktivizoni këtë funksion, konsumi i energjisë ulet dhe temperatura rritet me 2 °C në pajisje. Ushqimet qëndrojnë të freskëta, por kohëzgjatja e ruajtjes së tyre shkurtohet.

| Zona e temperaturës | Cilësimi i rekomanduar | Temperatura me E-Saver aktiv |
|---|---|---|
| -18 ℃ | -18 °C | -16 °C |

*Temperaturat*

### Aktivizimi i E-Saver

▶ Shtypni shigjetën e navigimit aq herë derisa të shfaqet funksioni përkatës.




*Fig. 15*

▶ Kryeni hapat e veprimit (shihni Fig. 1095) .
▷ Modaliteti i kursimit të energjisë aktivizohet.

### Çaktivizimi i E-Saver

▶ Shtypni shigjetën e navigimit aq herë derisa të shfaqet funksioni përkatës.




*Fig. 16*

▶ Kryeni hapat e veprimit (shihni Fig. 1096) .
▷ Modaliteti i kursimit të energjisë çaktivizohet.

## IceMaker*

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni prodhimin e kubave të akullit.

| | |
|---|---|
| Informacione të tjera për sasinë e kubave të akullit: | (shihni 9.1 Të dhënat teknike) |
| Informacione të tjera për rritjen e sasisë së kubave të akullit: | (shihni MaxIce*) |
| Informacione të tjera për madhësinë e kubave të akullit: | |
| Informacione të tjera për pastrimin e linjave të IceMaker: | (shihni TubeClean*) |

### Aktivizimi i IceMaker

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
❑ Është realizuar furnizimi me ujë në lidhjen fikse të ujit. Shihni manualin e montimit.*
❑ IceMaker është vënë në punë. (shihni 7.5 IceMaker*)

▶ Shtypni shigjetën e navigimit aq herë derisa të shfaqet funksioni përkatës.




*Fig. 17*

▶ Kryeni hapat e veprimit (shihni Fig. 1097) .
▷ IceMaker aktivizohet. Mund të nevojiten deri në 24 orë derisa IceMaker të prodhojë kubat e parë të akullit.

### Çaktivizimi i IceMaker

▶ Shtypni shigjetën e navigimit aq herë derisa të shfaqet funksioni përkatës.




*Fig. 18*

▶ Kryeni hapat e veprimit (shihni Fig. 1098) .
▷ IceMaker çaktivizohet.
▷ Prodhimi aktual i kubave të akullit do të përfundojë.
▷ IceMaker fiket automatikisht.

## Kubat e akullit*

Ky cilësim mundëson rregullimin individual të madhësisë së kubave të akullit.*

**Zgjedhja e cilësimit***

▶ Vendosni vlerën në menynë e klientit (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .

## MaxIce*

Me këtë funksion ju rritni sasinë e kubave të akullit të IceMaker.

| | |
|---|---|
| Informacione të tjera për sasinë e kubave të akullit: | (shihni 9.1 Të dhënat teknike) |

**Aktivizimi i MaxIce**

Nëse aktivizoni MaxIce dhe nuk e keni aktivizuar më parë funksionin IceMaker (shihni IceMaker*) , atëherë me MaxIce ju aktivizoni automatikisht edhe funksionin IceMaker.

Nëse nuk e keni aktivizuar akoma funksionin IceMaker, sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Është realizuar furnizimi me ujë në lidhjen fikse të ujit. Shihni manualin e montimit.*
❑ IceMaker është vënë në punë. (shihni 7.5 IceMaker*)

▶ Shtypni shigjetën e navigimit aq herë derisa të shfaqet funksioni përkatës.




*Fig. 19*

▶ Kryeni hapat e veprimit (shihni Fig. 1099) .
▷ MaxIce aktivizohet.
▷ Nëse nuk e keni aktivizuar akoma më parë funksionin IceMaker: IceMaker aktivizohet.

**Çaktivizimi i MaxIce**

Nëse çaktivizoni MaxIce, atëherë funksioni IceMaker vazhdon të mbetet i aktivizuar.

▶ Shtypni shigjetën e navigimit aq herë derisa të shfaqet funksioni përkatës.




*Fig. 20*

▶ Kryeni hapat e veprimit (shihni Fig. 1100) .
▷ MaxIce çaktivizohet.

## TubeClean*

Ky cilësim mundëson pastrimin e tubave të IceMaker.*

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:*

❑ Pastrimi i IceMaker bëhet gati (shihni 8.3.6 Pastrimi i IceMaker*) .

**Aktivizimi i cilësimit***

▶ Aktivizoni cilësimin në menynë e klientit (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .
▷ Procesi i shpëlarjes është duke u përgatitur (maks. 60 min): Simboli pulson.
▷ Tubat e ujit janë duke u shpëlarë: Simboli pulson.
▷ Procesi i shpëlarjes ka përfunduar: Funksioni çaktivizohet automatikisht.

## Drita e ekranit

Ky cilësim mundëson rregullimin gradual të dritës së ekranit.

Nivelet e dritës mund të vendosen si më poshtë:

- 40%
- 60%
- 80%
- 100%

**Zgjedhja e cilësimit**

▶ Vendosja e vlerës (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .

## Alarmi i derës

Ky cilësim mundëson vendosjen e kohës se deri kur bie alarmi i derës (shihni Mbyllja e derës) .

Këtu mund të vendosen vlerat e mëposhtme:

- 1 min
- 2 min
- 3 min
- Fikur

**Zgjedhja e cilësimit**

▶ Vendosja e vlerës (shihni 6.4 Mesazhet e gabimeve) .

## Bllokimi i panelit

Ky cilësim shmang përdorimin pa qëllim të pajisjes, p.sh. nga fëmijët.

Përdorimi:

- Shmangni ndryshimin pa qëllim të cilësimeve dhe të funksioneve.
- Shmangni fikjen pa qëllim të pajisjes.
- Shmangni rregullimin pa qëllim të temperaturës.

**Aktivizimi /çaktivizimi i cilësimit**

▶ Aktivizoni / çaktivizoni. (shihni 6.2 Logjika e përdorimit)

### Informacion

Ky cilësim bën të mundur leximin e informacioneve të pajisjes, si dhe aksesin në menynë për klientin.

Këtu mund të lexohen informacionet e mëposhtme:
- Emri i modelit
- Indeksi
- Numri i serisë
- Numri i shërbimit

**Hapja e informacioneve të pajisjes**

▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa të shfaqen cilësimet .
▶ Shtypni Konfirmo *Fig. 5 (2)*.
▶ Shtypni shigjetat e navigimit *Fig. 5 (1)* aq herë derisa të shfaqet ekrani me informacionin.
▶ Lexoni informacionet e pajisjes.

### Kujtesa

Kujtesat shfaqen në mënyrë akustike nëpërmjet një tingulli sinjalizues dhe në mënyrë vizuale nëpërmjet një simboli në ekran. Tingulli sinjalizues vjen duke u rritur vazhdimisht derisa mesazhi të përfundojë.

**Aktivizimi i cilësimit**

▶ Aktivizimi / çaktivizimi (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .

### Rivendosja në gjendje fillestare

Ky funksion bën të mundur rikthimin e të gjitha cilësimeve në cilësimet nga fabrika. Të gjitha rregullimet që keni kryer deri në atë moment, do të rikthehen në cilësimin e tyre fillestar.

**Aktivizimi i cilësimit**

▶ Aktivizoni (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .

## 6.4 Mesazhet e gabimeve

Mesazhet e gabimeve shfaqen në ekran. Ka dy kategori të mesazheve të gabimeve:

| Kategoria | Kuptimi |
|---|---|
| Mesazhi | Kujton për proceset e përgjithshme. Ju mund t'i ekzekutoni këto procese dhe kështu të eliminoni mesazhin. |
| Paralajmërimi | Shfaqet në rast problemesh në funksionim. Përveç treguesit në ekran, tingëllon edhe një sinjal. Tingulli i sinjalit vjen duke u forcuar, derisa ta konfirmoni treguesin duke e prekur atë. Problemet e thjeshta në funksionim mund t'i eliminoni edhe vetë. Për problemet e rënda duhet të kontaktoni me kujdesin për klientin. |

### 6.4.1 Paralajmërimet

**Mbyllja e derës**

Mesazhi shfaqet kur dera mbahet hapur shumë gjatë.

Koha se deri kur do të shfaqet mesazhi mund të përshtatet .
▶ Përfundimi i alarmit: Konfirmoni mesazhin.
**-ose-**
▶ Mbyllni derën.

**Shkëputje e energjisë elektrike**

Mesazhi shfaqet kur temperatura e ngrirjes rritet për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike. Pasi ndërprerja e energjisë elektrike të ketë përfunduar, pajisja vazhdon më tej punën me temperaturën e vendosur.
▶ Përfundimi i alarmit: Konfirmoni mesazhin.
▷ Shfaqet alarmi i temperaturës (shihni Alarmi i temperaturës) .

**Alarmi i temperaturës**

Mesazhi shfaqet kur temperatura nuk përputhet me temperaturën e vendosur.

Shkaku për diferencën e temperaturës mund të jetë:
- Futja në frigorifer e ushqimit të freskët të ngrohtë.
- Gjatë rregullimit dhe heqjes së ushqimeve, brenda ka qarkulluar shumë ajër i ngrohtë nga dhoma.
- Është ndërprerë energjia elektrike për kohë të gjatë.
- Pajisja është me defekt.

Pasi shkaku të jetë eliminuar, pajisja vazhdon më tej punën me temperaturën e vendosur.
▶ Konfirmoni tregimin.
▷ Tregohet temperatura më e ngrohtë.
▶ Konfirmoni sërish tregimin.
▷ Do të shfaqet treguesi i statusit.
▷ Tregohet temperatura aktuale.

**Gabim**

Ky mesazh shfaqet kur ndodh një defekt i pajisjes. Një pjesë e pajisjes shfaq një defekt.
▶ Hapni derën.
▶ Mbani shënim kodin e gabimit.
▶ Konfirmoni mesazhin.
▷ Tingulli sinjalizues pushon.
▷ Shfaqet treguesi i statusit.
▶ Mbyllni derën.
▶ Kontaktoni me kujdesin për klientin. (shihni 9.4 Kujdesi për klientin)

### 6.4.2 Mesazhet

**Vendosja e sirtarit të IceMaker***

Ky mesazh shfaqet kur sirtari i IceMaker është i hapur.
▶ Shtyni brenda sirtarin e IceMaker.
▷ Mesazhi fiket.
▷ IceMaker prodhon kuba akulli.

### 6.4.3 DemoMode

Kur në ekran tregohet një simbol „D“, modaliteti i demonstrimit është aktiv. Ky funksion është i zhvilluar për shitësit, sepse të gjitha funksionet teknike të ftohjes janë të çaktivizuara.

**Çaktivizimi i DemoMode**

Kur në ekran shfaqet një kohë:
▶ Konfirmoni treguesin brenda kohës që ecën.
▷ DemoMode çaktivizohet.
Kur në ekran nuk shfaqet asnjë kohë:
▶ Hiqni spinën elektrike nga priza.
▶ Lidhni përsëri spinën elektrike.
▷ DemoMode çaktivizohet.

# 7 Pajisjet

## 7.1 Sirtarët

Ju mund t'i hiqni sirtarët për t'i pastruar ata.

Ju mund t'i hiqni sirtarët, që të përdorni VarioSpace.

Heqja dhe vendosja e sirtarëve ndryshon sipas sistemit të tërheqjes. Pajisja juaj mund të ketë sisteme të ndryshme me tërheqje/zgjatje.

**Shënim**
Konsumi i energjisë rritet dhe performanca e ftohjes zvogëlohet kur qarkullimi i ajrit nuk mjafton.
- ▶ Lëreni të vendosur në pajisje sirtarin më të poshtëm!
- ▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit brenda në faqen e pasme!

### 7.1.1 Sirtari i sipërm me anim*

Nëse sirtari i sipërm tërhiqet jashtë, ai anohet nga përpara. Kështu do të siguroni një shikim më të mirë brenda sirtarit. Ky funksion varet nga lartësia e pajisjes.

**Heqja e sirtarit**



*Fig. 21*
- ▶ Tërhiqni sirtarin jashtë deri në fund.
- ▶ Ngrini lart sirtarin në pjesën përpara.
- ▶ Ngrini lart sirtarin nga poshtë.
- ▶ Hiqeni sirtarin nga përpara.

**Vendosja e sirtarit**




*Fig. 22*
- ▶ Vendoseni sirtarin mbi ndaluesit e sipërm. *Fig. 22 (1)*
- ▶ Vendosni sirtarin pjerrtas prapa ndaluesve të sipërm mbi brinjën e kutisë. *Fig. 22 (2)*
- ▶ Ulni poshtë sirtarin.
- ▶ Shtyjeni për nga prapa.

### 7.1.2 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë

Sirtari lëviz direkt mbi brinjën e kutisë. Këtu nuk ka asnjë shinë.

**Heqja e sirtarit**




*Fig. 23*
- ▶ Tërhiqni sirtarin jashtë deri në fund.
- ▶ Ngrini lart sirtarin në pjesën përpara. *Fig. 23 (1)*
- ▶ Hiqeni sirtarin nga përpara. *Fig. 23 (2)*

**Vendosja e sirtarit**



*Fig. 24*
- ▶ Vendosni sirtarin pjerrtas prapa ndaluesve mbi brinjën e kutisë. (shihni Fig. 1104)
- ▶ Ulni poshtë sirtarin.
- ▶ Shtyjeni sirtarin brenda për nga prapa.

### 7.1.3 Sirtari më i poshtëm

Sirtari është sirtari më i poshtëm në pajisje. Ai lëviz direkt mbi brinjën e kutisë. Këtu nuk ka asnjë shinë.

**Heqja e sirtarit**




*Fig. 25*
- ▶ Tërhiqni sirtarin jashtë deri në fund.
- ▶ Ngrini lart sirtarin në pjesën përpara. *Fig. 25 (1)*
- ▶ Hiqeni sirtarin nga përpara. *Fig. 25 (2)*

**Vendosja e sirtarit**




*Fig. 26*
- ▶ Futeni sirtarin pjerrtas në ndalues *Fig. 26 (1)*.
- ▶ Ulni poshtë sirtarin.
- ▶ Shtyjeni sirtarin brenda për nga prapa.

## 7.2 Rafti me tërheqje me IceTower*




*Fig. 27 Rafti me tërheqje me IceTower*

**(1)** IceMaker

**(3)** Kutia për shembull për picë, pije alkoolike

**(2)** Tasi me varje për kubat e akullit
**(4)** Rafti me tërheqje

Mbi raftin me tërheqje ndodhet dy kuti të larta (IceTower). Në kutinë *Fig. 27 (2)* mblidhen dhe mbahen kubat e akullit nga IceMaker. Kutia *Fig. 27 (3)* është e përshtatshme për ruajtjen e ushqimeve të larta, si picat ose pijet alkoolike.

Rafti me tërheqje me IceTower është i montuar mbi një pllakë xhami me shina me tërheqje. Ju mund ta zbërtheni raftin me tërheqje për ta pastruar.

### 7.2.1 Zbërthimi i raftit me tërheqje me IceTower

**Heqja e kutisë**




*Fig. 28*

▶ Tërhiqni jashtë raftin me tërheqje.
▶ Ngrijeni kutinë *Fig. 28 (5)* lart përpara.
▶ Hiqni kutinë.




*Fig. 29*

▶ Hiqni tasin me varje *Fig. 29 (6)*.
▶ Nëse ai ka kuba akulli: Zbrazni tasin me varje.
▷ Kutia dhe tasi me varje hiqen dhe ju mund t'i pastroni ato. (shihni 8.3.4 Pastrimi i pjesëve)

**Heqja e raftit me tërheqje**

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Kutitë janë hequr. (shihni 7.2.1.1 Heqja e kutisë)




*Fig. 30*

▶ Shtyni brenda raftin me tërheqje. *Fig. 30 (7)*
▶ Ngrini lart raftin me tërheqje përpara majtas. *Fig. 30 (8)*
▶ Ngrini lart raftin me tërheqje përpara djathtas. *Fig. 30 (9)*
▷ Rafti me tërheqje është liruar përpara nga mbërthimi.
▶ Hiqeni nga përpara raftin me tërheqje. *Fig. 30 (10)*
▷ Rafti me tërheqje hiqet dhe ju mund ta pastroni atë. (shihni 8.3.4 Pastrimi i pjesëve)

**Heqja e pllakës së xhamit nën raftin me tërheqje**

(shihni 7.3 Pllakat e xhamit)

### 7.2.2 Vendosja e raftit me tërheqje me IceTower

**Vendosja e pllakës së xhamit nën raftin me tërheqje**

(shihni 7.3 Pllakat e xhamit)

**Vendosja e raftit me tërheqje**



*Fig. 31*

▶ Shtyni shinat brenda.




*Fig. 32*

▶ Vendosni raftin me tërheqje pjerrtas prapa gjuhëzave kapëse të përparme.
▶ Shtyjeni pjerrtas brenda. Bëni kujdes që në të dyja anët ndaluesi të jetë prapa gjuhëzës kapëse. *Fig. 32 (11)*
▶ Uleni poshtë përpara raftin me tërheqje. *Fig. 32 (12)*



*Fig. 33*

▶ Shtypni për poshtë raftin me tërheqje në pjesën përpara.
▷ Dëgjohet zhurma e mbërthimit të raftit me tërheqje.

**Vendosja e kutive**

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Rafti me tërheqje është vendosur. (shihni 7.2.2.2 Vendosja e raftit me tërheqje)




*Fig. 34*

▶ Tërhiqni jashtë raftin me tërheqje.
▶ Mbajeni me një dorë raftin me tërheqje.

**Shënim**
Kutitë janë me formë të tillë që nuk mund të shkëmbehen kurrë me njëra-tjetrën.

▶ Vendosni kutinë pjerrtas mbi raftin me tërheqje. *Fig. 34 (13)*
▶ Shtyjeni kutinë brenda pjerrtas për nga prapa. *Fig. 34 (14)*
▶ Uleni poshtë kutinë përpara. *Fig. 34 (15)*




*Fig. 35*

▶ Vendosni tasin me varje *Fig. 35 (6)* për kubat e akullit.
▶ Shtyni brenda raftin me tërheqje me kutinë (IceTower). *Fig. 35 (16)*
▷ Rafti me tërheqje me IceTower është vendosur plotësisht.

## 7.3 Pllakat e xhamit

**KUJDES**
Ndalohet heqja e pllakës së xhamit mbi IceTower!*
Dëmtime te IceMaker. Në pllakën e xhamit mbi IceTower është fiksuar IceMaker.
▶ Mos e hiqni pllakën e xhamit mbi IceTower.

Ju mund ta hiqni pllakën e xhamit poshtë sirtarëve që ta pastroni atë.

Ju mund ta hiqni pllakën e xhamit poshtë sirtarëve, në mënyrë që të përdorni VarioSpace.

### 7.3.1 Heqja / vendosja e pllakës së xhamit

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Pllaka e xhamit poshtë sirtarit: Sirtari është hequr. (shihni 7.1 Sirtarët)
❑ Rafti me tërheqje poshtë IceTower: IceTower është hequr. (shihni 7.2 Rafti me tërheqje me IceTower*) *

**Heqja e pllakës së xhamit**




*Fig. 36 Shembull ilustrues i pllakës së xhamit*

▶ Ngrijeni lart pllakën e xhamit përpara. *Fig. 36 (1)*
▶ Hiqeni pllakën e xhamit nga përpara. *Fig. 36 (2)*

**Vendosja e pllakës së xhamit**



*Fig. 37 Shembull ilustrues i pllakës së xhamit*

▶ Vendosni pllakën e xhamit pjerrtas prapa ndaluesve. (shihni Fig. 1117)
▶ Ulni poshtë pllakën e xhamit.
▶ Shtyjeni pllakën e xhamit për nga prapa.

## 7.4 EasyTwist-Ice*

EasyTwist-Ice prodhon kuba akulli me anë të depozitës së ujit të vendosur.

EasyTwist-Ice shërben vetëm për të prodhuar kuba akulli në sasi të zakonshme për familje.

**Shënim**
Mos e ndryshoni pozicionin e EasyTwist-Ice.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- EasyTwist-Ice është pastruar (shihni 8.3.5 Pastrimi i EasyTwist-Ice*)
- Depozita e ujit është pastruar.
- Sirtari EasyTwist-Ice është futur plotësisht brenda.

### 7.4.1 Mbushja e depozitës së ujit

**PARALAJMËRIM**
Uji i papastër!
Helmime.
▶ Mbusheni vetëm me ujë të pijshëm.

**KUJDES**
Lëngjet që përmbajnë sheqer!
Dëmtim i EasyTwist-Ice.
▶ Mbusheni vetëm me ujë të pijshëm të ftohtë.

**Shënim**
Nga përdorimi i ujit të filtruar dhe të dekarbonizuar, arrihet cilësia më e mirë e mundshme e ujit të pijshëm për prodhimin e kubave të akullit pa probleme.
Kjo cilësi uji mund të arrihet me një filtër uji për tavolinë që blihet në një dyqan të specializuar për këto pajisje.
▶ Mbusheni enën e ujit vetëm me ujë të pijshëm të filtruar dhe të dekarbonizuar.

Furnizimi me ujë i EasyTwist-Ice realizohet nëpërmjet një depozite uji.




*Fig. 38*

▶ Ngrijeni pak lart depozitën e ujit në pjesën prapa *Fig. 38 (1)* dhe hiqeni nga lart *Fig. 38 (2)*.
▶ Mbusheni me ujë të pijshëm deri te shenja.
▶ Vendosni në vend depozitën e ujit në rendin e kundërt të heqjes.

### 7.4.2 Prodhimi i kubave të akullit

Kapaciteti prodhues varet nga temperatura e ngrirjes. Sa më e ulët të jetë temperatura, aq më shumë kuba akulli mund të prodhohen në një periudhë kohe të caktuar.

Kapaciteti maksimal i sirtarit të kubave të akullit – 40 copë (përgatitja 2 herë e kubave të akullit).

Koha e nevojshme për prodhimin e kubave të akullit – të paktën 5 orë.

**Lirimi i kubave të akullit**
▶ Rrotulloni dorezën me rrotullim deri në fund nga e djathta.
▶ Nëse nevojitet, përsëriteni disa herë dhe rrotullojeni dorezën pak më shumë.

## 7.5 IceMaker*

IceMaker shërben vetëm për të prodhuar kuba akulli në sasi të zakonshme për familje.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
- IceMaker është pastruar (shihni 8 Mirëmbajtja) .
- Sirtari IceMaker është pastruar.
- Sirtari IceMaker është futur plotësisht brenda.

### 7.5.1 Prodhimi i kubave të akullit

Kapaciteti prodhues varet nga temperatura e ngrirjes. Sa më e ulët të jetë temperatura, aq më shumë kuba akulli mund të prodhohen në një periudhë kohe të caktuar.

Pasi IceMaker ndizet për herë të parë, mund të nevojiten deri në 24 orë që të prodhohen kubat e parë të akullit.
▶ Aktivizoni funksionin IceMaker (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .
▶ Për të prodhuar shumë kuba akulli: Aktivizoni funksionin MaxIce (shihni 6.2 Logjika e përdorimit) .
▶ Shpërndani njëtrajtësisht kubat e akullit në sirtar, për të rritur sasinë e mbushjes.
▶ Mbyllja e sirtarit: IceMaker fillon sërish automatikisht me prodhimin e akullit.

**Shënim**
Kur në sirtarin e IceMaker arrihet një nivel i caktuar mbushjeje, nuk prodhohen më kuba akulli të tjerë. IceMaker nuk e mbush sirtarin deri në buzë.

## 7.6 VarioSpace



*Fig. 39*

Ju mund t'i hiqni sirtarët dhe pllakat e xhamit nga pajisja. Në këtë mënyrë ju siguroni hapësirë për ushqimet e mëdha, si p.sh. shpendët, mishi, copat e mëdha të kafshëve të egra të gjahut dhe produktet e larta për pjekje. Si rezultat, këto mund të ngrihen të plota dhe të përgatiten më pas si të tilla.
▶ Mbani parasysh kufijtë e ngarkesës së sirtarëve dhe pllakave të xhamit (shihni 9.1 Të dhënat teknike) .

## 7.7 Aksesorët

### 7.7.1 Pllaka ftohëse*

Pllakat ftohëse parandalojnë rritjen e shpejtë të temperaturës në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Pllakat e ftohjes janë në sirtar.

Ju mund t'i vendosni pllakat ftohëse në tabakanë e ngrirjes.*

**Përdorimi i pllakës ftohëse**



*Fig. 40*

Kur pllakat ftohëse janë të ngrira:
▶ Shtrojini mbi produktet e ngrira, në pjesën përpara lart të ndarjes së ngrirjes.

# 8 Mirëmbajtja

## 8.1 Çmontimi / montimi i sistemit me tërheqje

### 8.1.1 Shënime për zbërthimin

Ju mund t'i zbërtheni disa sisteme me tërheqje për t'i pastruar. Pajisja juaj mund të ketë sisteme të ndryshme me tërheqje/zgjatje.

Sistemet më tërheqje në vijim janë të çmontueshëm ose jo të çmontueshëm:

| Sistemi me tërheqje | i çmontueshëm / jo i çmontueshëm |
|---|---|
| Sirtari i sipërm me anim* | jo i çmontueshëm* |
| Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë | i çmontueshëm (shihni 8.1.2 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë) |
| Sirtari më i poshtëm | jo i çmontueshëm |
| IceTower* | i çmontueshëm (shihni 8.1.3 IceTower*) * |

### 8.1.2 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë

**Zbërthimi i sistemit me tërheqje**

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Sirtari është hequr. (shihni 7.1.2 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë)




*Fig. 41 Pjesa kapëse në brinjën e djathtë të kutisë*

▶ Kapni pjesën kapëse poshtë nga prapa.
▶ Tërhiqni anash pjesën kapëse në pjesën e pasme. *Fig. 41 (1)*
▶ Tërhiqni anash pjesën kapëse në pjesën e përparme. *Fig. 41 (2)*

**Montimi i sistemit me tërheqje**




*Fig. 42 Pjesa kapëse në brinjën e djathtë të kutisë*

▶ Vendoseni pjesën kapëse përpara në brinjën e kutisë. *Fig. 42 (1)*
▶ Shtyni pjesën kapëse në pjesën e pasme. *Fig. 42 (2)*

### 8.1.3 IceTower*

**Zbërthimi i sistemit me tërheqje**

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ IceTower është hequr. (shihni 7.2 Rafti me tërheqje me IceTower*)
❑ Pllaka e xhamit është hequr. (shihni 7.3 Pllakat e xhamit)

▶ Vendosni raftin me tërheqje mbi tavolinë.
▷ Kështu mund t'i hiqni më lehtë shinat nga pllaka e xhamit.



*Fig. 43 Pllaka e xhamit me shinat dhe pjesët mbajtëse*

▶ Shtypni për poshtë pjesën mbajtëse në pjesën prapa (shihni Fig. 1123) dhe në të njëjtën kohë shtyni shinën për nga pas.



*Fig. 44 Pllaka e xhamit me shinat dhe pjesët mbajtëse*

▷ Kapësët e shinave lirohen nga pjesa mbajtëse.
▶ Hiqni shinën nga pjesa mbajtëse.



*Fig. 45 Pllaka e xhamit me pjesët mbajtëse*

▶ Hiqni nga anash pjesën mbajtëse nga pllaka e xhamit.

**Montimi i sistemit me tërheqje**



*Fig. 46 Pllaka e xhamit me pjesët mbajtëse*

▶ Vendosni pjesën mbajtëse mbi pllakën e xhamit.
▶ Shtyni pjesën mbajtëse deri në fund në pllakën e xhamit.



*Fig. 47 Njësia e zbutjes së mbylljes*

Në shinën e majtë është e fiksuar njësia e zbutjes së mbylljes. (shihni Fig. 1127) Në shinën e djathtë nuk ka të fiksuar asnjë njësi të zbutjes së mbylljes.




*Fig. 48 Pllaka e xhamit me shinat dhe pjesët mbajtëse*

Montimi i shinës **me** njësi të zbutjes së mbylljes:

▶ Vendosni kapësen e shinës mbi vrimat e pjesës mbajtëse **të majtë**. *Fig. 48 (1)*
▶ Tërhiqni shinën për nga përpara. *Fig. 48 (2)*
▷ Dëgjohet zhurma e kapjes së shinës në pjesën prapa.

Montimi i shinës **pa** njësi të zbutjes së mbylljes:

▶ Vendosni kapësen e shinës mbi vrimat e pjesës mbajtëse **të djathtë**. *Fig. 48 (1)*
▶ Tërhiqni shinën për nga përpara. *Fig. 48 (2)*
▷ Dëgjohet zhurma e kapjes së shinës në pjesën prapa.

## 8.2 Shkrirja e pajisjes

### 8.2.1 Shkrirja me NoFrost

Shkrirja kryhet automatikisht nëpërmjet sistemit NoFrost. Lagështia precipiton vetë mbi serpentinë, shkrihet dhe avullon në mënyrë periodike.

Pajisja nuk duhet shkrirë.

**Shënim**
Në bazamentin e pajisjes mund të grumbullohen pika uji.
Kur e nxirrni pajisjen jashtë pune:

▶ Shtroni një shami përpara pajisjes, për të mbledhur pikat e mundshme të ujit që rrjedhin jashtë. (shihni 10 Nxjerrja jashtë pune)

## 8.3 Pastrimi i pajisjes

### 8.3.1 Parapërgatitja

**PARALAJMËRIM**
Rrezik nga goditja elektrike!

▶ Hiqni spinën e frigoriferit ose ndërpritni furnizimin me energji elektrike.

**PARALAJMËRIM**
Rrezik zjarri

▶ Mos dëmtoni qarkun e ftohjes.

▶ Zbrazni pajisjen.
▶ Hiqni spinën elektrike.

### 8.3.2 Pastrimi i trupit

**KUJDES**
Pastrimi i gabuar!
Dëmtime në pajisje.

▶ Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
▶ Mos përdorni sfungjer gërryes ose gërvishtës ose lesh teli metalik.
▶ Mos përdorni asnjë mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

**PARALAJMËRIM**
Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga avulli i nxehtë!
Avulli i nxehtë mund të shkaktojë djegie dhe të dëmtojë sipërfaqet.

▶ Mos përdorni asnjë pajisje pastrimi me avull!

▶ Fshini kasën nga jashtë me një leckë të butë e të pastër. Në rast ndotjeje të fortë, përdorni ujë të vakët me pastrues neutral. Sipërfaqet prej xhami mund të pastrohen gjithashtu me pastrues për xhama.

### 8.3.3 Pastrimi i hapësirës së brendshme

**KUJDES**
Pastrimi i gabuar!
Dëmtime në pajisje.

▶ Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
▶ Mos përdorni sfungjer gërryes ose gërvishtës ose lesh teli metalik.
▶ Mos përdorni asnjë mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

▶ Sipërfaqet plastike: pastrojini me dorë me një pecetë të butë e të pastër, me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
▶ Sipërfaqet metalike: pastrojini me dorë me një pecetë të butë e të pastër, me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.

### 8.3.4 Pastrimi i pjesëve

**KUJDES**
Pastrimi i gabuar!
Dëmtime në pajisje.

▶ Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
▶ Mos përdorni sfungjer gërryes ose gërvishtës ose lesh teli metalik.
▶ Mos përdorni asnjë mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

**Pastrimi me një pecetë të butë e të pastër, ujë të vakët dhe pak detergjent:**

- Rafti me tërheqje IceTower*
- Sirtari
  Mbani parasysh: Mos e hiqni magnetin që ndodhet te sirtari! Magneti siguron funksionimin e IceMaker.*
- Tabakaja e ngrirjes*

**Pastrimi në larëse enësh deri në 60 °C:**

- Forma e kubave të akullit*
- Lopata e kubave të akullit*

▶ Zbërthimi i pjesëve: shihni kapitullin përkatës.
▶ Pastroni pjesët.

### 8.3.5 Pastrimi i EasyTwist-Ice*

Pastrimi duhet kryer në rastet më poshtë:

❑ Vënia në punë herën e parë
❑ Mospërdorimi për më shumë se 48 orë
❑ Ka nevojë për pastrim.

**Në vënien në punë herën e parë, gjatë mospërdorimit për kohë të gjatë ose kur ka nevojë për pastrim**




*Fig. 49*

▶ Hiqni depozitën e ujit *Fig. 49 (1)* dhe sirtarin e kubave të akullit *Fig. 49 (2)*.
▶ Nxirrni jashtë sirtarin e ngrirjes me EasyTwist-Ice.




*Fig. 50*

▶ Shtypni gjuhëzën *Fig. 50 (1)*, ngrini lart EasyTwist-Ice në pjesën prapa dhe nxirreni jashtë nga sirtari i ngrirjes.




*Fig. 51*

▶ Shtypni njëkohësisht gjuhëzat *Fig. 51 (1)* në të dyja anët e EasyTwist-Ice dhe hiqni nga lart kapakun *Fig. 51 (2)*.




*Fig. 52*

▶ Shtypni të gjitha gjuhëzat *Fig. 52 (1)* njëra pas tjetrës dhe hiqni kapakun *Fig. 52 (2)*.
▶ Pastroni sirtarin e kubave të akullit, depozitën e ujit dhe EasyTwist-Ice me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
▶ Montoni EasyTwist-Ice.




*Fig. 53*

▶ Futni akset *Fig. 53 (1)* në EasyTwist-Ice brenda në udhëzues dhe shtypni pjesën e pasme *Fig. 53 (2)* derisa gjuhëza të mbërthehet në vend.
▶ Shtyni brenda sirtarin e EasyTwist-Ice.

**PARALAJMËRIM**
Uji i papastër!
Helmime.
▶ Mbusheni vetëm me ujë të pijshëm.

▶ Mbushni me ujë depozitën e ujit dhe vendoseni në vend. (shihni 7.4.1 Mbushja e depozitës së ujit)

Me ujë të pafiltruar:
▶ Hidhni kubat e akullit që janë prodhuar 24 orë pas prodhimit të parë të kubave të akullit.

Me ujë të filtruar:
▶ Hidhni kubat e akullit që janë prodhuar 48 orë pas prodhimit të parë të kubave të akullit.

### 8.3.6 Pastrimi i IceMaker*

IceMaker mund të pastrohet në mënyra të ndryshme.

Pastrimi duhet kryer në rastet më poshtë:

❑ Vënia në punë herën e parë
❑ Mospërdorimi për më shumë se 5 ditë.*

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Sirtari i IceMaker është i zbrazur.
- ❑ Sirtari i IceMaker është futur brenda.
- ❑ IceMaker është aktivizuar. (shihni 6.2 Logjika e përdorimit)

**Në vënien në punë herën e parë ose pas mospërdorimit për kohë të gjatë**

Pastroni IceMaker me funksionin TubeClean.

▶ Futni një enë boshe 1,5 l (lartësia maksimale 10 cm) në sirtarin nën IceMaker.
▶ Aktivizoni funksionin TubeClean. (shihni 6.2 Logjika e përdorimit)
▷ Procesi i shpëlarjes është duke u përgatitur (maks. 60 min): Simboli pulson.
▷ Tubat e ujit janë duke u shpëlarë: Simboli pulson.
▷ Procesi i shpëlarjes ka përfunduar: Funksioni çaktivizohet automatikisht.
▶ Hiqni IceMaker dhe hiqni edhe enën e futur.
▶ Pastroni sirtarin e IceMaker me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
▶ Shtyni brenda sirtarin e IceMaker.
▷ Prodhimi i kubave të akullit fillon automatikisht.
▶ Hidhni kubat e akullit që janë prodhuar 24 orë pas prodhimit të parë të kubave të akullit.

**Nëse nevojitet pastrim**

Pastroni IceMaker manualisht.

▶ Hiqni sirtarin e IceMaker dhe pastrojeni me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
▶ Shtyni brenda sirtarin e IceMaker.
▷ Prodhimi i kubave të akullit fillon automatikisht.

### 8.3.7 Pas pastrimit

▶ Thani pajisjen dhe pjesët përshtatëse duke i fërkuar.
▶ Lidhni pajisjen dhe ndizeni.
▶ Aktivizoni funksionin SuperFrost (shihni 6.3 Funksionet) . Kur temperatura të jetë mjaftueshëm e ftohtë:
▶ Futni ushqimet.
▶ Përsëritni pastrimin rregullisht.

# 9 Ndihma për klientin

## 9.1 Të dhënat teknike

| Diapazoni i temperaturave | |
|---|---|
| Ngrirja | -28 °C deri në -15 °C |

| Sasia maksimale e ngrirjes / 24h | |
|---|---|
| Dhoma e ngrirjes | Shihni etiketën e parametrave te „Kapaciteti i ngrirjes ... /24h“ |

| Pesha maksimale e ngarkimit të pajisjeve | | | |
|---|---|---|---|
| Pajisjet | Gjerësia e pajisjes 550 mm (shihni instruksionet e montimit, Përmasat e pajisjes) | Gjerësia e pajisjes 600 mm (shihni instruksionet e montimit, Përmasat e pajisjes) | Gjerësia e pajisjes 700 mm (shihni instruksionet e montimit, Përmasat e pajisjes) |
| Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë (shihni 7.1.2 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë) | 14 kg | 19 kg | 19 kg |

| Pesha maksimale e ngarkimit të pajisjeve | | | |
|---|---|---|---|
| Pajisjet | Gjerësia e pajisjes 550 mm (shihni instruksionet e montimit, Përmasat e pajisjes) | Gjerësia e pajisjes 600 mm (shihni instruksionet e montimit, Përmasat e pajisjes) | Gjerësia e pajisjes 700 mm (shihni instruksionet e montimit, Përmasat e pajisjes) |
| Sirtari më i poshtëm (shihni 7.1.3 Sirtari më i poshtëm) | -- | 11 kg | 19 kg |
| Sirtari i sipërm me anim* (shihni 7.1.1 Sirtari i sipërm me anim*) * | --* | 19 kg* | 19 kg* |

| Prodhimi i kubave të akullit me IceMaker* | |
|---|---|
| Prodhimi i kubave të akullit / 24 h | Në temperaturë -18 °C: 0,8 kg kuba akulli |
| Prodhimi maksimal i kubave të akullit / 24 h | Kur funksioni MaxIce është aktiv: 1,2 kg kuba akulli |

| Prodhimi i kubave të akullit me EasyTwist-Ice* | |
|---|---|
| Kohëzgjatja në -18 °C | rreth 5,5 orë |
| Kohëzgjatja me SuperFrost të aktivizuar | rreth 3 orë |

## 9.2 Zhurmat gjatë punës

Pajisja shkakton nivele të ndryshme zhurme gjatë funksionimit të saj.

- Në **performancë të ulët ftohjeje** pajisja punon duke kursyer energji, por punon më gjatë. Niveli i zhurmës është më **i ulët**.
- Në **performancë të lartë ftohjeje** ushqimet ftohen më shpejt. Niveli i zhurmës është më **i lartë**.

  Shembuj:
  - funksionet e aktivizuara (shihni 6.3 Funksionet)
  - ventilatori që punon
  - ushqimi i vendosur i freskët
  - temperatura e lartë e ambientit
  - dera e mbajtur hapur gjatë

| Zhurma | Shkaku i mundshëm | Lloji i zhurmës |
|---|---|---|
| Zhurmë qarkullimi dhe gurgullime | Agjenti ftohës qarkullon në qarkun e ftohjes. | Zhurmë pune normale |
| Fërshëllimë dhe shfryrje | Agjenti ftohës injektohet në qarkun e ftohjes. | Zhurmë pune normale |
| Gumëzhimë | Pajisja është duke ftohur. Niveli i zhurmës varet performanca e ftohjes. | Zhurmë pune normale |
| Zukatje dhe fështfërimë | Ventilatori është duke punuar. | Zhurmë funksionimi normale |



*** Në varësi nga modeli dhe pajisja**

| Zhurma | Shkaku i mundshëm | Lloji i zhurmës |
|---|---|---|
| Klikim | Komponentët ndizen dhe fiken. | Zhurmë veprimi normale |
| Kërcitje ose zukamë | Valvulat ose ventilet janë aktive. | Zhurmë veprimi normale |
| Trokitje e qetë, gumëzhimë ose zukatje* | Valvula është aktive. | Zhurmë funksionimi normale |

| Zhurma | Shkaku i mundshëm | Lloji i zhurmës | Mënjanimi |
|---|---|---|---|
| Dridhje | Montimi i papërshtatshëm | Zhurmë gabimi | Niveloni horizontalisht pajisjen nëpërmjet këmbëve me rregullim. |

| Zhurma | Shkaku i mundshëm | Lloji i zhurmës | Mënjanimi |
|---|---|---|---|
| Kërcitje | Pajisjet,<br>Objektet në brendësi të pajisjes | Zhurmë gabimi | Fiksoni pjesët e pajisjeve.<br>Lini distancë midis objekteve brenda. |

## 9.3 Defektet teknike

Pajisja juaj është projektuar dhe prodhuar në mënyrë të tillë që të garantohet siguria e funksionimit dhe jetëgjatësia e madhe. Por megjithatë kur gjatë përdorimit shfaqet një problem, verifikoni nëse problemi është shkaktuar si rezultat i një gabimi në përdorim. Në këtë rast, duhet të merrni në konsideratë kostot e riparimit, edhe gjatë periudhës së garancisë.

Problemet që jepen në vijim mund t'i eliminoni vetë.

### 9.3.1 Funksioni i pajisjes

| Gabimi | Shkaku | Zgjidhja |
|---|---|---|
| **Pajisja nuk punon.** | → Pajisja nuk është e ndezur. | ▶ Ndizni pajisjen. |
| | → Spina nuk është futur saktë në prizën elektrike. | ▶ Kontrolloni spinën. |
| | → Siguresa në prizën elektrike nuk është në rregull. | ▶ Kontrolloni siguresën. |
| | → Shkëputje e energjisë elektrike | ▶ Mbani të mbyllur pajisjen.<br>▶ Mbrojtja e ushqimeve: Shtroni pllakat ftohëse lart mbi ushqime ose përdorni një frigorifer ngrirës tjetër, nëse shkëputja e energjisë elektrike zgjat shumë.<br>▶ Mos i ngrini përsëri ushqimet e shkrira. |
| | → Spina e pajisjes nuk është futur mirë në pajisje. | ▶ Kontrolloni spinën e pajisjes. |
| **Temperatura nuk është mjaftueshëm e ftohtë.** | → Dera e pajisjes nuk është e mbyllur siç duhet. | ▶ Mbyllni derën e pajisjes. |
| | → Qarkullimi i ajrit dhe ajrimi nuk është i mjaftueshëm. | ▶ Mbani të lirë dhe pastroni rrjetën e ajrimit. |
| | → Temperatura e ambientit është shumë e lartë. | ▶ Zgjidhja e problemit: (shihni 1.4 Fusha e përdorimit e pajisjes) . |
| | → Pajisja është hapur shumë shpesh ose për kohë të gjatë. | ▶ Pritni për të parë nëse temperatura e kërkuar do të rivendoset vetvetiu. Nëse jo, kontaktoni me kujdesin për klientin (shihni 9.4 Kujdesi për klientin) . |
| | → Janë futur sasi shumë të mëdha ushqimi të freskët pa funksionin SuperFrost. | ▶ Zgjidhja e problemit: (shihni SuperFrost) |
| | → Temperatura është vendosur gabim. | ▶ Vendosni temperaturë më të ftohtë dhe kontrollojeni pas 24 orësh. |
| | → Pajisja ndodhet shumë pranë një burimi nxehtësie (sobë, kalorifer etj.). | ▶ Ndryshoni vendin e pajisjes ose të burimit të nxehtësisë. |
| **Guarnicioni i derës është me defekt ose duhet ndërruar për arsye të tjera.** | → Guarnicioni i derës është i ndërrueshëm. Ai mund të ndërrohet pa vegla pune shtesë. | ▶ Kontaktoni me kujdesin për klientin (shihni 9.4 Kujdesi për klientin) . |

| Gabimi | Shkaku | Zgjidhja |
|---|---|---|
| **Pajisja ka zënë akull ose formohet ujë nga kondensimi.** | → Guarnicioni i derës mund të ketë dalë nga kanali. | ▶ Kontrolloni futjen e duhur të guarnicionit të derës në kanal. |
| **Pajisja është e ngrohtë* në sipërfaqet e jashtme.** | → Ngrohtësia e qarkullimit të ftohjes përdoret për mënjanimin e ujit të kondensimit. | ▶ Kjo është normale. |

### 9.3.2 Pajisjet

| Gabimi | Shkaku | Zgjidhja |
|---|---|---|
| **IceMaker nuk mund të ndizet.*** | → Pajisja dhe për rrjedhojë IceMaker nuk janë të lidhur. | ▶ Lidhni pajisjen (shihni instruksionet e montimit). |
| **IceMaker nuk prodhon kuba akulli.*** | → IceMaker nuk është i ndezur. | ▶ Aktivizoni IceMaker. |
| | → Sirtari i "IceMaker" nuk është mbyllur siç duhet. | ▶ Mbyllni sirtarin në mënyrën e duhur. |
| | → Linja e furnizimit me ujë nuk është hapur. | ▶ Hapni furnizimin me ujë.* |

## 9.4 Kujdesi për klientin

Fillimisht provoni nëse mund ta eliminoni vetë defektin (shihni 9 Ndihma për klientin) . Nëse nuk ia dilni dot, kontaktoni me kujdesin për klientin.

Adresën e gjeni në broshurën bashkëlidhur „Shërbimi i Liebherr“.

**PARALAJMËRIM**

Riparim jo profesional!

Lëndime.

- ▶ Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje dhe në kordonin e lidhjes elektrike, të cilat nuk përmenden në mënyrë specifike (shihni 8 Mirëmbajtja) , duhen kryer vetëm nga kujdesi për klientin.
- ▶ Ndërroni kordonin e dëmtuar të lidhjes elektrike vetëm te prodhuesi ose nga shërbimi i tij për klientin ose te një person me kualifikim të ngjashëm.
- ▶ Në pajisjet me spinë frigoriferi, ndërrimi lejohet të bëhet nga klienti.

### 9.4.1 Kontakti me kujdesin për klientin

Sigurohuni që keni gati informacionet e mëposhtme të pajisjes:

- ❑ Emërtimi i pajisjes (Modeli dhe indeksi)
- ❑ Nr. i shërbimit (Shërbimi)
- ❑ Numri i serisë (S-Nr.)

- ▶ Hapni informacionet e pajisjes nëpërmjet ekranit (shihni Informacion) .

**-ose-**

- ▶ Merrni informacionet e pajisjes nga etiketa e parametrave (shihni 9.5 Etiketa e parametrave) .

- ▶ Mbani shënim informacionet e pajisjes.
- ▶ Njoftoni kujdesin për klientin: Komunikojini defektin dhe informacionet e pajisjes.
- ▷ Kjo bën të mundur një shërbim të shpejtë dhe të fokusuar.
- ▶ Ndiqni instruksionet e tjera të kujdesit për klientin.

## 9.5 Etiketa e parametrave

Etiketa e parametrave ndodhet prapa sirtarëve në anën e brendshme të pajisjes.




*Fig. 54*

**(1)** Emërtimi i pajisjes
**(2)** Nr. i shërbimit
**(3)** Numri i serisë

- ▶ Lexoni informacionet e etiketës së parametrave.

# 10 Nxjerrja jashtë pune

- ▶ Zbrazni pajisjen.
- ▶ Çaktivizoni IceMaker .*
- ▶ Fikni pajisjen .
- ▶ Hiqni spinën elektrike.
- ▶ Nëse nevojitet, hiqni spinën e pajisjes: Tërhiqeni jashtë dhe njëkohësisht lëvizeni nga e majta në të djathtë.
- ▶ Shtroni një shami përpara pajisjes, për të mbledhur pikat e mundshme të ujit që rrjedhin jashtë.
- ▶ Pastroni pajisjen (shihni 8.3 Pastrimi i pajisjes) .
- ▶ Lëreni derën hapur që të mos krijohen erëra të këqija.



* Në varësi nga modeli dhe pajisja

# 11 Hedhja/asgjësimi

## 11.1 Përgatitja e pajisjes për asgjësimin

Në disa pajisje Liebherr përdor bateri. Në BE, për arsye të mbrojtjes së mjedisit, ligjvënësi e ka detyruar përdoruesin fundor që t'i heqë këto bateri përpara hedhjes së pajisjeve të vjetra. Nëse pajisja juaj përmban bateri, në pajisje është vendosur edhe udhëzimi përkatës për këtë qëllim.

Llambat — Në rast se ju mund t'i hiqni vetë llambat pa i dëmtuar ato, çmontoni gjithashtu edhe llambat përpara hedhjes së pajisjes.

- ▶ Nxirreni pajisjen jashtë pune.
- ▶ Pajisjet me bateri: Hiqni bateritë. Shihni kapitullin **Mirëmbajtja**.
- ▶ Nëse është e mundur: Çmontoni llambat pa i dëmtuar ato.

## 11.2 Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike

Pajisja përmban ende materiale të vlefshme dhe duhet dërguar në grumbullimin e veçuar, i ndryshëm nga mbetjet e paklasifikuara shtëpiake.

Hidhini bateritë të ndara më vete nga pajisja e vjetër. Për këtë, mund t'i ktheni pa pagesë bateritë në dyqan ose në pikat e riciklimit dhe të mbledhjes së materialeve të ripërdorshme.

Llambat — Hidhini llambat e çmontuara në pikat përkatëse të grumbullimit.

Për Gjermaninë: — Ju mund ta hidhni pajisjen pa pagesë në pikat lokale të riciklimit dhe të mbledhjes së materialeve të ripërdorshme, në koshat e klasës 1. Kur blihet një frigorifer ftohës / ngrirës i ri dhe sipërfaqja e dyqanit është > 400 $m^2$, dyqani pranon gjithashtu dorëzimin e pajisjes së vjetër pa pagesë.

**PARALAJMËRIM**

Gaz ftohës dhe vaj që del jashtë!

Zjarr. Gazi ftohës i pajisjes është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Vaji që përmban pajisja është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës dhe vaji që rrjedh jashtë mund të marrë flakë në rast përqendrimit të lartë përkatës dhe në kontakt me një burim nxehtësie të jashtëm.

- ▶ Mos dëmtoni tubacionet e qarkut të gazit ftohës dhe kompresorin.

- ▶ Transportoni pajisjen pa e dëmtuar atë.
- ▶ Hidhni bateritë, llambat dhe pajisjen sipas udhëzimeve të përshkruara më lart.

home.liebherr.com/fridge-manuals

SQ Frigorifer ngrirës

Data e botimit: 20230324

**Indeksi i nr. të artikullit: 7088347-01**

Liebherr-Hausgeräte Ochsenhausen GmbH
Memminger Straße 77-79
88416 Ochsenhausen
Deutschland